REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL Nr.1
Datë 22.01.2026 ora 11 : 00 ᵒᵒ

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës "Njoftim", të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.248.Prot datë 22.01.2026, me rend dite si më poshtë :

1- Miratim i rendit të ditës.
2- Miratim i procesverbalit Nr.12, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 24.12.2025.
3- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%".
4- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2026 nga fondi i pushtetit vendor".
Materialet e pikës 3 dhe 4 do ju vihen në dispozicion ditën e Martë datë 20.01.2026, pasi për arsye të mosfunksionimit të sistemit kanë mbetur pa u përgatitur.
5- Miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për "Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara".
6- Miratimin i projekt - vendimit, "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2027-2029 dhe buxhetit vjetor".
7- Miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura".
8- Miratim i projekt - vendimit, "Për zëvendësimin e vakancave të krijuara në komisionet e këshillit bashkiak".
9- Shqyrtim i situatës së krijuar nga përmbytjet e ndodhura gjatë muajit Janar 2026, në territorin e bashkisë Rrogozhinë.
10- Shqyrtim i dy kërkesave të anëtares së këshillit bashkiak znj. Silvana Aliu.
Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 24.12.2025.
11- Të ndryshme.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

- *Shqyrtim i shkresës së Ministrisë së Financave, mbi mosrespektimin e kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.*
- *Të tjera.*

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Erind Tosku, Shpatik Kolgega, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Sokol Gosa, Lije Dedej, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Renato Kalemi, Altin Tosku, Lorena Baku, Mitat Daja, Dhurata Meka, Saimir Cani, Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Hekuran Xhani.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Astrit Mertiri - Administratori i Njësisë Administrative Kryevidh.
4. Deshir Gjumsi - Administratori i Njësisë Administrative Lekaj.
5. Denis Sako - Administratori i Njësisë Administrative Gosë.
6. Mexhit Saliu - Administratori i Njësisë Administrative Sinaballaj.
7. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
8. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
9. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
10. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
11. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
12. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
13. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
14. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
15. Lorenc Boriçi - Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.
16. Adriatik Lekaj - Përgjegjësi i zyrës së emergjencave civile.
17. Besnik Dushku - Shefi i MZSH-së.
18. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshmëm, 11- Këshilltarë, z. Shpati Kogega i bashkohet në vijim mbledhjes së këshillit.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!
-Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : Erind Tosku, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Sokol Gosa, Lije Dedej, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Mukades Gixhari.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 26.11.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar janë si më poshtë :

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 24.12.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr . 49 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%
Vendim nr . 50 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i pushtetit vendor.
Vendim nr . 53 . Për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit të arsimit parauniversitar.
Vendim nr . 54 . Për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit profesional.
Vendim nr . 55 . Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2026.
Vendim nr . 56 . Për shpalljen "Qytetar Nderi" Presidentit të Republikës së Shqipërisë SH.T.Z. Bajram Begaj.

Gjithashtu lexojmë dhe konfirmimin ligjor të ardhur nga prefekti i qarkut Tiranë për vendimet e datës 24.12.2025:

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Vendim nr . 51 . Për miratimin e realizimit Faktik të Buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Rrogozhinë.
Konfirmohet referuar ligjit 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe ligjit nr.68/2017 "Për financat e vtëqeverisjesvendore".
Vendim nr . 52 . Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028.
Konfirmohet referuar ligjit 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe ligjit nr.68/2017 "Për financat e vtëqeverisjesvendore".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Prefekt : Afrim Qëndro.

Mukades Gixhari . Para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës ju kam dërguar dje në grupin e këshillit në ëhatsapp, Projektvendimin, "Për miratimin e projektit Qendra e Kulturës 'Haxhi Memolla' Qendër Multifunksionale" dhe projektvendimin "Për miratimin e detajimit të fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga buxheti i shtetit", gjithashtu ju kam fotokopjur sot dhe nje projektvendim, "Për miratimin në parim të deklaratës për bashkëfiancim të familjeve që do të përfitojnë nga programi për "Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pavaforizuara për vitin 2026" Projektvendim ky që ka lidhje me pikën 5 të rendit të ditës. Gjithashtu keni të fotokopjuar për njohje dhe një raport për punën e këshillit të bashkisë Rrogozhinë për 12-mujorin e vitit 2025.
Jeni dakord t'i përfshijmë në rendin e ditës këto materiale? E hedhim në votim.
Për çfarë nuk jeni dakort zonja Silvana? Po zoti Indrit ,

Slvana Aliu . Për parregullsitë që ka projektvendimi.

Mukades Gixhari . Për cilin?

Silvana Aliu . Për pallatin e kulturës.

Edison Memolla . Të ju shpjegoj atëherë ne kemi kurse tek qendra e kulturës edhe duke pasur parasysh që ata kurset duam t'i krijojnë një ... të bëjmë një projekt që do të jetë më afatgjatë për kurse dhe menduam këtë gjë nëse e shikoni të arsyeshme nëse ka parregullsi ligjore t'i shikojmë.

Silvana Aliu . Atëherë forma e kontratës nuk sqarohet.

Edison Memolla . Një vjeçare.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Orges Tosku . Atëherë ky si projekt është një vjeçare që kemi parashikuar sepse mësuesi i pikturës dhe koreografi janë të punësuar diku tjetër dhe me atë pagë nga punësimi i dytë i dilte paga 150 mijë lekë të vjetra dhe ne menduam të bëjmë një projekt një vjeçar. Sepse këto kanë qenë të punësuar për katër muaj edhe këtyre klasa e pikturës dhe kërcimi...

Silvana Aliu . Nuk të vë faj duke qenë që nuk ka kaluar tek komisioni i ekonomisë...

Orges Tosku . Ne ishim në mbledhje...

Indrit Dedej . Komisioni nuk u mblodh.

Orges Tosku . E diskutojmë dhe këtu.

Indrit Dedej . Unë do isha i mendimit pse nuk bën bashkia kontrata për shembull për zyra e urbanistikës një inxhinier një topograf që si kemi.

Edison Memolla . I kemi vende vakante, po keni një topograf me licensë na e thoni... Indrit e kemi në strukturë dhe e kemi vend vakant që merr një rrogë goxha të mirë.

Erind Tosku . Ta shtyjmë radh për mbledhjen e radhës tjetër?

Indrit Dedej . Ta bëjmë pak serioze, asnjë komision nuk është mbledhur.

Edison Memolla . Ne kemi qenë prezentë drejtorët kanë qenë, nëse nuk shikoni të arsyeshme ok nëse e shikoni ok.

Erind Tosku . Për mua është jam dakord në qoftë se ka pyetje që doni të keni përgjigje keni përgjigje për aq më mirë.

Alime Hoxha . Kryetare më fal, a do futet apo nuk do futet tek rendi i ditës? Tani këtë po diskutojmë. Jeni dakort ta fusni tek rendi i ditës? Jo, ato nuk janë dakort për ta futur te rendi ditës.

Mukades Gixhari . Këtë pikë, vetëm këtë.

Indrit Dedej . Edhe këtë që e kaluam kryetare vendimi numër 54 s'jemi dakord ...

Mukades Gixhari . Vendimi 54 për miratimin e bursave....?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Indrit Dedej . Vendimi 56.

Sokol Gosa . Janë specialistë të fushës këtë?

Orges Tosku . Është Altin Kërçuku mësuesi i vizatimit, është dhe një koreograf.

Sokol Gosa . Është nga Rrogozhina?

Orges Tosku . Jo, është nga Durrësi ka një shtëpi që merret ...

Fatmira Thartori . Për mua futeni në rendin e ta diskutojmë pastaj. Është gjëe mirë që ne kemi një risi të re.

Alime Hoxha . Për mua le të futet në rendin e ditës.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim , jeni dakord t'i fusim në rendin e ditës? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, përfshirja në rendin e ditës e projektvendimit, ,"Për miratimin e projektit Qendra e Kulturës 'Haxhi Memolla' Qendër Multifunksionale" , e projektvendimit "Për miratimin e detajimit të fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga buxheti i shtetit", e projektvendimit , "Për miratimin në parim të deklaratës për bashkëfiancim të familjeve që do të përfitojnë nga programi për "Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pavaforizuara për vitin 2026" , si dhe raporti për punën e këshillit të bashkisë Rrogozhinë për 12-mujorin e vitit 2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, Miratim i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, Miratim i procesverbalit Nr.12, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 24.12.2025. E hedhim në votim, pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mukades Gixhari . Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%". Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social Ledian Hasani . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike? Po zonja Silvana.

Silvana Aliu . Këtu 7 familje janë me mbiemër Xhafa, që janë të gjithë familjet që janë lart,

Enver Memolla . Si e ka emrin ajo?

Ledian Hasani . Marjeta, ka qenë muajin tjetër nuk është këtë muaj, normalisht nuk mund ta fusim gjatë gjithë kohës me fondet e bashkisë.

Silvana Aliu . Mundohu që t'i orientosh drejt punës.

Ledian Hasani . Ne i kemi orientuar por ato nuk duan...

Silvana Aliu . Edhe kështu mësohen...

Edison Memolla . Nuk është kjo zgjidhje, e mira është që ato të integrohen, të shkojnë në shkollë.

Ledian Hasani . Problemi është që ata shkojnënë shkollë dhe nuk mësojnë, se normalisht një që është në klasë të pestë edhe nuk di një fjali nuk është normale.

Mukades Gixhari . Mbledhjes ju bashkua dhe këshilltari zoti Shpati Kolgega.

Enver Memolla . Kemi pasur një ndihmë të menjëhershme në Dhjetor dhe nuk ka ardhur akoma.

Ledian Hasani . Kemi pritur buxhetin, kemi pritur atë kam folur edhe me Rezin edhe kemi pritur pjesën e buxhetit që të miratohet buxheti në Prefekturë. Është bërë ajo borderoja Rez?

Rezart Vogli . Po patjetër, ka problem sistemi prandaj nuk po kaloj dot as paga asnjë gjë tjetër. Është bërë gati por kemi tre ditë që nuk kemi as sistem asgjë.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër? E hedhim në votim pro, kundra, abstenim. Të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) -vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim, pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Vendim nr.1. Miratohet me 12- vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetari i bashkisë me Nr.292.Prot datë 20.01.2026, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%", si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.292/1.Prot datë 20.01.2026.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën katër, miratim i projektvendimit për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin janar 2026 nga fondi i pushtetit vendor. Vazhdojmë po me zotin Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Janë 15 familje që janë përfituese dhe fondi është 85 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike? Ndonjë sugjerim? E hedhim në votim. E hedhim në votim. Pro, kundra, abstenim, të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) -vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim, pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr .2. Miratohet me 12- vota pro, projektvendimi, i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.291.Prot datë 20.01.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2026 nga fondi i pushtetit vendor", si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.291/1.Prot datë 20.01.2026.

Mukades Gixhari . Miratimi i projektvendimit "Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara". Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social zoti Ledion Hasani. Meqë ka lidhje po me këtë pikë, e marrim në shqyrtim dhe projektvendimin "Për miratimin në parim të deklaratës për bashkëfinancim të familjeve që do përfitojë nga programi për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2026". Zoti Ledian.

Ledian Hasani . Atëherë në total janë katër familje përfituese dhe fondi është 4 milion 500.000 4 milion e 500 mijë lekë. Unë kam sjellë dhe një fond që sapo foli zonja Mukades për deklaratën e bashkëfinancimit sepse këto familje domethënë 30% financon Bashkia dhe 70% Ministria. Paraprakisht duhet një deklaratë që ne jemi dakort. Diku tek 15 milion lekë të vjetra i bie që do i fusi bashkia dhe pjesën tjetër ministria. Por që të aplikojmë duhet patjetër deklarata.
Normalisht lista duhet të kishte kaluar pak më përpara.

Enver Memolla . Është kriter bashkëfinacimi po nuk bëre këtë nuk bën dot aplikimin.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Indrit Dedej . Vetëm për këto është?

Ledian Hasani . Vetëm për këto të 4. Po ta shikoni këtu e kam shpjeguar tek kjo pjesë që bashkia merr përsipër 1 milion e 400 mijë lekë, kurse domethënë i bie vlera 30% e 4 milion 500 mijë lekëshit. Kurse ministria merr 3 milion 300 mijë lekë 70% të vlerës.

Indrit Dedej . Mua më pëlqen që disa shpjegime shifrat bëhen edhe në kllapa se ju i fusni një shifër aty zero, zero. Sembrapa nuk merren vesh ka shkuar datë 21 kapi 26.

Ledian Hasani . Jo nuk shtoj dot zero unë. Tek relacioni jua kam shpjeguar 4 familje. Ato zerot duhen justifikuar mbrapa.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim me radhë. E hedhim në votim me radhë, fillimisht, "Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për "Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara". Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) -vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim, pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr .3. Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetari i bashkisë me Nr.247.Prot datë 16.01.2026, "Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për "Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara" si dhe Relacionin shpjegues me Nr.247/1.Prot datë 16.01.2026.

Mukades Gixhari . Hedhim në votim projektvendimin , "Për miratimin në parim të deklaratës për bashkëfinancim të familjeve që do të përfitojnë nga programi për 'Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pavaforizuara për vitin 2026' ". E hedhim në votim, pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12-vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim, projektvendimi me Nr.337, datë 21.01.2026, "Për miratimin në parim të deklaratës për bashkëfinancim të familjeve që do të përfitojnë nga programi për 'Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pavaforizuara për vitin 2026' ".

Vendim nr .4. Miratohet me 12- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me Nr.337, datë 21.01.2026, "Për miratimin në parim të deklaratës për bashkëfinancim të

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

familjeve që do të përfitojnë nga programi për 'Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pavaforizuara për vitin 2026' ", si dhe Relacioni shpjegues i këtij vendimi me Nr.337/1.Prot datë 21.01.2026.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6, miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2027-2029 dhe buxhetit vjetor". Relaton drejtori i financës z. Rezart Vogli. Zoti Rezart përshëndetje.

Rezart Vogli . Përshëndetje! Me këtë projektvendim ne i kërkojmë këshillit bashkiak të miratojë kalendarin për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029. Në projektvendim janë pasqyruar datat të cilët do t'i respektoj për të përgatitur programin buxhetor afatmesëm.

Alime Hoxha . Tani ju ngelet vetëm ta zbatoni.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje për zotin Rezart për pikën gjashtë?

Enver Memolla . Thjeshtë ta marrin në zbatim se ky miratim plan punë është.

Alime Hoxha . Zbatoni këtë që miratoni, këtë duam ne.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim pro, kundra, abstenim. Të gjithë pro, miratohet.

Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) - vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.

Vendim nr .5. Miratohet me 12-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i bashkisë me Nr.5552.Prot datë 23.12.2025."Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2027-2029 dhe buxhetit vjetor".

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 7, miratim i projekt - vendimit, "Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura". Vazhdojmë po me drejtorin e financës, zotin Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Nga ana e buxhetit të shtetit çdo vit janë akorduar fonde për bashkinë e Rrogozhinës qëllimi i këtyre fondeve është shlyerja e detyrimeve të prapambetura, për vitin 2025, fondi i akorduar nga buxheti i shtetit është me masën 28 milion 555 mijë e 270 lekë ashtu siç e thashë qëllimi është likudimi i faturave të prapambetura të cilat kanë një afat 30 ditor të pa

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

likuiduara nga ana e institucionit që kanë kanë një radhë për një rishikim nga më i vjetri dri tek më i riu. Shpërndarja që kemi bërë është për investimet edhe për shpenzimet operative. Shpenzimet operative e kam përmendur dhe në këshill bashkiak ne jemi fokusuar vetëm tek likuidimi i detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike.

Erind Tosku . Keni biznese që i likuidon që nuk janë më debitorë bashkia ndaj biznesit?

Edison Mmeolla . Primare do jetë energjia elektrike, pjesa tjetër.

Indrit Dedej . Duhet të jetë e përcaktuar ne thjeshtë e kalojmë po se çfarë do kalojmë.

Rezart Vogli . Edhe ne nuk e kemi të përcaktuar...

Indrit Dedej . Ti thua do i kalosh por ndoshta nuk i kalon fare. Marr shkas nga kjo letra këtu, Ministria e shtetit ky Malaj dhe unë shumë herë kam thënë marrim nga jashtë kontroll sepse ne si këshilltar nuk kemi mundësi as juridike as ekonomike që ne të ju bëjmë audit ju. Dhe kjo thotë kështu ju bëjmë me dije që në 2023-in ju nuk raportoni fare, dhe si të besoj unë ty që ti do japësh lekët këtyre.

Edison Memolla . Çdo gjë është online, në programet që ti sheh çdo pagesë që bëhet ...

Indrit Dedej . Dhe ai audit që ka ardhur këtu ka ardhur sa me u tall, sepse ju thatë që këto shkojnë tek ministria e Financave. Nësene nukkemi këtu një emër që këto do shkojnë tek OSHE-ja.

Edison Memolla . Atëherë OSHE-ja fillon që në 2007 borxhet OSHE-së e bashkisë ndaj OSHE-së edhe gjithë kjo shumë t'i shkojë OSHE-së prapë ne nuk dalim dot ta zerojmë, pjesa më e madhe po themi gati gjysma do i shkojë OSHE-së gjysma do i shkojë bizneseve që janë kronologji më të mirë. Po kronologjinë s'mund se aty janë me dhjetra janë borxhe që janë që në 2000 që edhe për komunat kanë borxhe ... janë borxhe të lara nuk do bëhet asnjë investim dhe çfarë janë punë të bëra.

Erind Tosku . Po mirë mund të bësh atë që thitë Indriti psh që mbledhjen e radhës, t'i thuash që me këtë borxh që kishim ne i kemi dhënëshpërndarjen edhe kaq...

Edison Memolla . Mbledhjen e radhës ne ju japim kronoligjinë se kush i ka marrë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mukades Gixhari . Dëgjojmë z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Kryetare faleminderit, bashkangjitur kësaj që tha Indriti është e vlefshme për diçka tjetër se edhe ne si këshill bashkak kemi të drejtë auditimi por duke kërkuar atë që ka informacioni në bazë që kur bëjmë të ardhurat, për sa i përket kësaj kjo është gjë e mirë që mos na ndodhi ajo pjesa tjetër që ndodhi para një vit e sa kur u bllokua buxheti nga privati për mos likuidim.

Edison Memolla . Me vendim gjyqësor...

Enver Memolla . Po e kam parasysh çfarë është, ky është deleguar thjesht për borxhet nuk është për investime ... e keni vetë në dorë pjesën penale e mbrapa. Për mua është në rregull si projektvendim thjeshtë pasqyrimin se kush është bërë atëherë na duhet.

Edison Memolla . Mbledhjen e radhës jua sjellim gjithë veprimet...

Indrit Dedej . Nuk ka shans që të vijë më një vendim që të bllokojë atë sepse një gjyq zgjat 15 vjet.

Enver Memolla . E bën me përmbarimin pa mbaruar gjyqi.

Alime Hoxha . Përmbarimi e merr dhe pa mbaruar gjyqi.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) - vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim pika 7 (shtatë) e rendit të ditës.

Vendim nr .6. Miratohet me 12- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me Nr.119.Prot datë 12.01.2026, "Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", si dhe relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.119/1.Prot datë 12.01.2026.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 8, Miratim i projekt - vendimit, "Për zëvendësimin e vakancave të krijuara në komisionet e këshillit bashkiak". Presim . Fjala është për dy kryetarët e grupeve. Bëhet fjalë për zotin Enver Memolla i cili dha dorëheqjen nga komisioni i titujve të nderit.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Enver Memolla . I Përkohshëm, jashtë këshillit bashkiak.

Alime Hoxha . Është komision i përkohshëm.

Mukades Gixhari . Po, komision i përkohshëm dhe zoti Mitat Daja dha dorëheqje nga kryetar i komisionit juridik i rendit dhe konflikteve. Kush e don fjalën nga... po zonja Alime Hoxha.

Alime Hoxha . Atëherë për zëvendësimin e zotit Enver Memolla nga komisioni i përkohshëm i dhënies së titujve të nderit propozojmë Gezime Met-hasanin.

Mukades Gixhari . Në vend të zotit Enver Memolla propozohet zonja Gezime Met-hasani. Ai ka dhënë dorëheqjen si kryetar jo si anëtar.

Alime Hoxha . Ne do bëjmë një propozim tjetër po nga jashtë domethënë po aty, atëherë për komisionin juridik rend dhe konflikte propozojmë si kryetar në vend të zotit Mitat Daja, zotin Enver Memolla dhe Lulzim Hasa del nga komisioni.

Mukades Gixhari . Del nga komisioni?

Alime Hoxha . Po.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim të dy propozimet.

Alime Hoxha . Ai ka dhënë dorëheqjen si naëtar i komisionit jo se largohet nga komisioni.

Mukades Gixhari . Anëtar është në komision. Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. znj. Silvana ? Je kundër? Ok, atëherë 11 vota pro, 1 votë kundër. Miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) - vota pro, 1 (një)-votë kundër, 0 (zero) -vota abstenim pika 8 (tetë) e rendit të ditës.

Vendim nr .7. Miratohet me 11-vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetarja e këshillit bashkiak me Nr.344.Prot datë 22.01.2026 "Për zëvendësimin e vakancave të krijuara në komisionet e këshillit bashkiak", si dhe relacioni shpjegues i këtij projektvendimi me Nr.344/1.Prot datë 22.01.2026.

Mukades Gixhari . Tani para se të kalojmë, të nderuar këshilltarë para se të kalojmë tek pika 9,

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

të ezaurojmë projektvendimet se kemi dy projektvendimet që i kemi tek WhatsApp, që i diskutuam përpara se të fillonim mbledhjen. Bëjmë dhe ato dy projektvendime, pastaj kalojmë rikthehemi te pika nëntë. "Për miratimin e detajimit të fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkisë për vitin 2025 me burim financimi nga buxheti nga buxheti i shtetit". Materialin e keni të gjithë përpara. Zoti Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Ashtu si në rastin e fondit të detyrimit prapambetura, në këtë rast buxheti i shtetit ka shpërndarë një grant bazuar në performancën për secilën njësi dhe të qeverisjes vendore. Bashkia e Rrogozhinës ka plotësuar disa kritere dhe në bazë të këtyre kritereve ka përfituar një fond. Fondi në total është në shumën 3 milion e 14 mijë e 954 pikë 39 lekë. Këto janë të shpërndara, janë të ndara, ky fondi 1 milion 348 mijë e 314 lekë është fond i cili është përndarë nga burimi i të ardhurave të brendshme dhe qëllimi i këtij projektvendimi është që këto fonde duhet të destinohen në një program të caktuar me qëllim që buxheti i shtetit të rialokojë fondin e dytë, pjesën e dytë. Në total bashkia Rrogozhinë ka përfituar, vetëm kjo vlerë është...3 milion është në total gjithë fondi i përfituar , ne jemi të detyruar të detajojmë këtë fond dhe detajimi dhe adresimi i këtij fondi ka shkuar vetëm tek drejtoria arsimore, domethënë për objekte arsimore për çdo gjë që ka lidhje me arsimin. Vetëm tek arsimi, me miratimin e këtij për vendimi dhe me marrjen e konfirmimit nga ana e prefekturës ne jemi të detyruar që këtë dokumentacion t'ia dorëzojmë ministrisë së financave me qëllim rialokimin e pjesës së dytë të përfituar, siç thashë ky burim është burimi i brendshëm ndërsa kësti i dytë është burimi i huaj. Është e miratuar por thjeshtë duhet të adrsojmë fondin e parë kështin e parë me qëllim përfitimin e kështit të dytë. Ky është një fond që nuk do përdoret menjëherë, por do përdoret gjatë vitit në bazë kërkesave që do ketë drejtoria arsimore, në bazë kërkesë që do... ky është fond po nga buxheti i shtetit fond shtesë.

Erind Tosku . Po pra nga bashkia ka një fond për buxhetin për arsimin ...

Rezart Vogli . Ky është plus atje.

Erind Tosku . Ok.

Edison Memolla . Kemi kaluar buxhetin e bashkisë, plus atij buxheti shtohen dhe ky buxhet pjesës së arsimit.

Indrit Dedej . Nëse ka kohë them ta kalojmë ... ta bëjmë serioze.

Rezart Vogli . Në ç'kuptim atëherë ky projektvendim duhet t'i drejtohet Ministrisë së Financave me qëllim...

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Edison Memolla . Jo thotë për kohën, ka afat.

Rezart Vogli . Jo jo, fati është ky duhet të kalojë tani me qëllim që ne të bëjmë kërkesën për rialokimin e pjesës së dytë, ky është qëllimi. Edhe ky nuk ishte nuk është një kërkesë e jona, kjo është një kërkesë nga bashkitë e forta nga Eneida , ajo na adresoi që këtë fond do ta sjellim.

Indrit Dedej . Të kishte ardhur pak më herët.

Rezart Vogli . Po tani na e solli.

Erind Tosku . Lekë ka sjellë.

Alime Hoxha . Një pyetje Rez, ju do t'ia çoni projektin ministrisë do ta çoni në ministri, projektvendimin në ministri ju do ta çoni të detajuar pra këto fonde vërtetë do shkojnë për arsim po për një, dy, tre gjëra apo thjesht do t'u çohet që kjo do shkojë për arsimin.

Rezart Vogli . Siç është shpërndarja programi 9120 lidhet vetëm me arsimin parashkollor.

Alime Hoxha . E kuptova. Po e kisha pyetjen që...

Edison Memolla . Nuk ndryshon destinacioni.

Alime Hoxha . Dakord nuk e ndryshoni destinacionin. Po e kisha fjalën tek ndarja e fondeve. Për shembull po e marrim shembull një pjesë e fondit do shkojë për një rikonstruksion të një ose një tjetër do shkojë për mjete mësimore, pra këtu e kisha do ndahet? Projektvendimi që ju do t'i çoni ministrisë, do shkojë thjeshtë që ky fond siç është sjellë këtu shkon për arsimin, apo do të jetë i detajuar që kaq fonde për këtë...

Rezart Vogli . Nuk do jetë i detajuar për sa kohë ne nuk kemi të detajuar se për çfarë do i shpenzojmë këto, thjeshtë do shpenzohen për arsimin vetëm kaq.

Alime Hoxha . Po pjesa e dytë nuk është e thënë që duhet të jetë po në këtë destinacion.

Rezart Vogli . Nuk e dimë deri në këto momente udhëzimin se ku duhet të destinohet pjesa e dytë.

Alime Hoxha . Jo e kam fjalën që nuk është e thënë se duhet të jetë në këtë destinacion patjetër, pjesa e dytë?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Rezart Vogli . Nuk kam informacion për ktë.

Edison Memolla . Mund ta dërgonim edhe në vend të tjera, po duke ditur që arsimi është më i rëndësishëm, ne duam që ta dërgojmë tek arsimi se kjo është më pika më ...

Alime Hoxha . Jam shumë dakord.

Erind Tosku . Pastaj po bashkia bën ndarjen e gjërave, kërkesave sipas zërave të drejtorisë ...

Rezart Vogli . Mjafton të jetë shpenzim për objekte arsimore dhe ky fond shkon atje.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) - vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim projektvendimi "Për miratimin e detajimit të fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga buxheti i shtetit".

Vendim nr .8. Miratohet me 12, vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetari i bashkisë me Nr.306.Prot datë 20.01.2026 "Për miratimin e detajimit të fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga buxheti i shtetit", si dhe relacioni i këtij projektvendimi me Nr.306/1, datë 20.01.2026.

Mukades Gixhari . Kalojmë në projektvendimin tjetër , "Për qendra e Kulturës "Haxhi Memolla" qendër multifunksionale". Relaton drejtori i Arsim, Kulturës, Rinisë dhe sporteve z. Orges Tosku.

Orges Tosku . Atëherë si e diskutuam edhe më parë ky është një projektvendim që lidhet me qendrën me pallatin e kulturës për ta kthyer në një qendër multifunksionale. Ku në fokus është fusha e kërcimit dhe pikturës, qëllimi i këtij projekti është nevojat që ka komuniteti, fëmijët, sepse duke parë dhe privatisht kurse kërcimi apo pikture nuk është se ofrohen shumë edhe nga privati në qytetin e Rrogozhinës. Ne kemi bërë një studim para katër muajsh duke punësuar një korograf edhe një piktor, për të parë dhe ecurinë që do të ketë ky projekt që ne e kemi sjellë tani. Ka qenë mjaft pozitiv, fëmijë ka pasur goxha edhe nga familjarët është mirëpritur goxha mirë. Si periudhë, si kohëzgjatje të këtij projekti kemi menduar një periudhë njëvjeçare që të mbyllet me 31 dhjetor 2026. Kërkon punësimin e një korografi që ne e kemi dhe një mësuesi të pikturës që gjithashtu është domethënë. Mendojmë që paga për këto dy të punësuar të jetë minimalisht paga minimale sepse se edhe më pak duke qenë se janë profesionistë nuk është që gjen që kanë interes për të ardhur, kjo është pak a shumë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Alime Hoxha . Tani ky është projekt shumë i mirë për fëmijët e bashkisë Rrogozhinë po me sa di deri tani janë vetëm fëmijët e Rrogozhinës që vijnë aty. A ka mundësi që t'u krijojmë mbështetje që të na dhe fëmijët nga zonat se mund të ketë fëmijë.

Orges Tosku . Atëherë aty nuk ka vetëm fëmijë nga Rrogozhina. Vijnë edhe nga Lekaj edhe nga...

Alime Hoxha . Po pra po ka dhe nga ata që nuk kanë mundësi të vijnë vetë.

Orges Tosku . Është e pamundur transporti.

Alime Hoxha . Nëse mundet... jo çdo ditë por dy ditë në javë për shembull se ndoshta nuk mund të vijnë të gjithë ...

Orges Tosku . Kjo është e pamundur sepse mund të ketë fëmijë nga Lekaj mund të ketë...

Alime Hoxha . Po pra po e kuptoj nga zona të ndryshme ...për shembull t'i marrim nga Lekaj edhe në Gosë nuk po them të shkojmë t'i marrim në fshat atje ku janë, po të paktën të dalin deri aty ku është rruga kryesore.

Edison Memolla . Jam dakord tek kjo pjesë që të bëhet por kemi dhe arsimin që e kemi të detyrueshëm që duhet parë me prioritet kjo që ju thoni. Kurse kjo është një gjë plus.

Alime Hoxha . Gjë plus për këtë po themi që është gjë plus

Edison Memolla . Duket ditur që është gjë plus, kaq që ne po marrim përsipër besoj që është e mjaftueshme.

Silvana Aliu . Ajo që thotë Alimeja është shumë mirë sepse është gjë plus po ti në moment po kërkon dhe talentet që ka zona. Kështu njëherë në javë për shembull mund të përcaktosh...

Edison Memolla . Duke ja hequr pagesën e kursit sepse këto do bëheshin me pagesë dikur nëse do kishte talente, këtu do t'i bëjmë falas me mësues me gjithë kushtet e duhura, kështu që është për momentin është e pamundur kështu që është pastaj...

Fatmira Thartori . Unë do të propozoja diçka tjetër, sikur këto mësues sa janë në javë sa ditë janë javë?

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Orges Tosku . Pothuajse përditë. Ato të pikturës për ditë me grupmosha të ndryshme.

Fatmira Thartori . Ok për ditë në rregull do të thoja katër të bëjnë Rrogozhinën një ditë në Lekaj ...

Orges Tosku . Nuk ke institucione ku do ezhvillosh.

Fatmira Thartori . Tek shkollat do ishte gjëja më e mirë .

Alime Hoxha . Jo nuk mund të vijnë dot nëpër shkolla sepse nuk mund të cënosh procesi mësimor.

Fatmira Thartori . Them pasdite.

Alime Hoxha . Për shkollat qendër komunitare ajo duhet të jetë në plan të shkollës. Në qoftë se do ta zbatojë shkolla si qendër komunitare mund ta bëjë vetë shkolla një kërkesë.

Fatmira Thartori . Jo e kisha fjalën këtu që shkolla është e hapur dhe pasdite dhe është qendër komunitare dhe ka ambiente...

Edison Memolla . Ka disa mjete që këtë bëjnë kurse nuk është se e bëjnë pa gjë, duke i lëvizur...

Erind Tosku . Më shumë sesa ideja që të jenë për mendimin tim të shtohen më shumë kurse në qoftë se kemi mundësi. Të dyja janë për momentin dhe avash avash domethënë do ndërtohet gjëja. Ajo gjëja që mua më shqetëson më shumë është mbarëvajtja dhe ecuria e rregullt e këtyre specialistëve në ardhje në sistemin e pallatit të kulturës. Sepse ne i japim rrogën minimale në qoftë se ai e ka për të ardhur katër herë në ditë vjen dy herë, rroga i bie të jetë të jetë po kaq, ai thjeshtë merr rrogën dhe s'vjen dhe na dështon ky projekti, kështu që këtë e keni parasysh që të mos cedojë.

Orges Tosku . Do jetë në monitorim.

Erind Tosku . Tjetër unë e shoh që dhe ju si drejtori të shikoni dhe për gjëra të tjera që komuniteti ka më nevojë. Piktura, koreografia janë gjërat shumë të rëndësishme, por kemi dhe gjëra të tjera. Me kalimin e kohës mund t'i rrisim pagën, mund të rrisim specialistët që mund t'i bëjnë dhe në Lekaj që mos të vijnë në Rrogozhinë dhe të bëjnë vende të tjerë. Pra mos e shohim vetëm për këtu, ta shohim për një projekt më të madh. Pra ta shtojmë, ta shtojmë gjënë. Vetëm

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

do kisha shumë merak që të vijnë dhe të përkushtohen, mos të neglizhojnë edhe mos të bëhen sikur mos vijnë, vijnë dy muajt e parë dhe pastaj jo po kam një hall pastaj...

Orges Tosku . Rrjete sociale ne kemi të gjithë, mjafton të futesh aty dhe të shohësh ecurinë që ka pasur këto 4 muaj.

Erind Tosku . E di se e kam ndjekur edhe gjëra të tjera, por dua që ta nisim që të rritet të mos e lëmë këtu e kisha.

Edison Memolla . Do bëhen provë këto dy pozicione ndoshta do jetë e duhur dhe të bëjmë kurse matematike, por duke e diturqë këto dy specialstë i gjetëm për momonetin dhe kishte interes për këto dy gjëra, ndërsa më vonë do ketë interes për të mësuar gjuhë anglisht ku e di unë, jemi të gatshëm që ta bëjmë një projekt të mirëfilltë sepse ajo gjithë godinë e re e mirë, i ofron gjithë kushtet dhe të bëhet pse mos bëhet.

Orges Tosku . Sot ofrohen edhe kurse anglishteje dhe gjermanishteje.

Fatmira Thartori . E keni projekt apo do futet...?

Orges Tosku . Është, është janë afruar dy mësuesë për gjuhët përkatëse, ne kemi thjesht që i japim ambientin përdorim.

Fatmira Thartori . Ka filluar?

Orges Tosku . Po.

Fatmira Thartori . Kur ka filluar?

Orges Tosku . Mund të bëjë dy javë, është edhe janë edhe ditët e caktuara të Enjten të Premten duhet me i parë ditët.

Edison Memolla . Është me kalendar .

Orges Tosku . Edhe është e hapur për të gjithë.

Erind Tosku . Mos cedoni tek kjo pjesë sepse është gjëja është gjëja më e bukur që i bëni komunitetit me thyer atë rutinën dhe me ndryshuar ...

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Orges Tosku . Koreografi do merret edhe me organizime gjatë vitit që mund të kemi 1 qershori festat kombëtare.

Silvana Aliu . Gjithsesi ne si bashki sidomos shkollat mund të justifikojnë nxënësit që kanë talent dhe ne si bashkim paguajmë rrugën këtë mund ta bëjmë.

Edison Memolla . Dhe atë e shohim në një fazë të dytë.

Alime Hoxha . Po e thoja që bashkëpunimi me qendrën kulturore ka filluar dhe për evidentimin e talenteve është diskutuar dhe me të gjithë drejtuesit e shkollave, me mësuesit që merren me aktivitete. Ju është lënë detyrë që evidentoni ato nxënës që kanë talente, kush në kërcime, kush në recitim apo kush në aktrim. I kemi, i kemi bërë këto. Domethënë jemi duke punuar me qendrën kulturore. Po kemi pasur këtë vështirësinë që jo të gjithë nxënësit mund të vijnë nga zonat për ta ndjekur këtu te qendra kulturore, nuk i kanë mundësitë. Prandaj e ngrita që në fillim atë nëse ka mundësi që t'ju ofrohet.

Edison Memolla . Kjo është një fazë e dytë.

Alime Hoxha . Në rregull e shikojmë më mbrapa në një projekt tjetër çfarë mund të kemi ndonjë gjë, që mund ta përmirësojmë për këtë. Por që është gjë e mirë sepse fëmijët nuk kanë nevojë vetëm për matematikë apo për gjuhë të huaj. Ka nevojë dhe për pikturën dhe për kërcimin dhe për të gjitha dhe shumë mirë që është marrë si nismë. Shumë mirë që është bërë, shumë mirë që të ngrihet edhe një grup kërcimi për qytetin që ne të kemi me çfarë të përfaqësohemi dhe kjo është një plus për ne.

Orges Tosku . Biles nesër ka edhe një aktivitet po për këta të rinisë.

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër abstenim, të gjithë pro. Miratohet

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) - vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim projektvendimi ,"Për qendra e Kulturës "Haxhi Memolla" Qendër multifunksionale.

Vendim nr .9. Miratohet me 12 vota pro , projektvendimi i propozuar nga kryetari i bashkisë me Nr.69/1.Prot datë 20.01.2026 "Për qendrën e Kulturës "Haxhi Memolla" Qendër Multifunksionale", si dhe relacioni i këtij projektvendimi me Nr.69/2.Prot datë 20.01.2026.

Mukades Gixhari . Rikthehemi tek pika nëntë. Faleminderit z. Orges. Shqyrtimi i situatës së

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

krijuar nga përmbytjet gjatë muajit janar 2026 në territorin e bashkisë Rrogozhinë, fjala për kryetarin e bashkisë zotin Edison Memolla.

Edison Memolla . Do ta them në mënyrë të përgjithshme pastaj Adriatiku do jua thotë më specifikisht, faktikisht kemi pasur disa përmbytje toka bujqësore edhe biznese në zonën e Spillesë. Pjesa e lumit dihet që doli mbi shtratin dhe pati përmbytje të tokave bujqësore që ka krijuar dhe dëm. Kemi ngritur një grup mbi verifikimin në terren, që do bëjë gjithë verifikimin e gjithë tokave bujqësore edhe bizneseve që kanë problematikat. Do plotësojmë gjithë dokumentacionin e duhur pastaj do drejtohemi qeverisë sepse dhe qeveria ka miratuar një fond të dedikuar për këtë pjesë por akoma nuk kemi një udhëzim të saktë se si do vazhdojmë. Ne kemi vazhduar paraprakisht që mos mbetemi në momentin që mos kemi kohën e duhur për të gjetur problematikat. Kështu që e përgjithshme është pjesa më me dëme ishte pjesa e Spillesë. Disa biznese atje, kanë bërë një ankesë që e kemi , dhe pjesa e grupit ka qenë në terren ka verifikuar dhe pastaj çfarë na takon ne do t'ia bëjmë të gjithë procedurat ligjore që na lejon. Pastaj për më shumë detaje do flasë dhe Adriatiku.

Adriatik Leka . Atëherë kemi qenë dhe herë të tjera dhe t'i ndajmë ca gjëra, plani i emergjencave civile konsiston në katër, pesë pika kryesore pika e parë është marrja e masave parandaluese, pika e dytë është njoftimi në kohë i fermerëve dhe bizneseve që të largohen nga rreziku, pika e tretë është ndihma që ne japim kur ata janë në rrezik dhe pika e katërt është kthimi në identitet dhe dëshpërblimi. Tani këtu ka shumë probleme, marrja e masave parandaluese lumit, ne nuk marrim dot masë parandaluese, sepse para viteve 90 ka qenë vetëm një masë parandaluese caktuar një vije e verdhë dhe poshtë vijës së verdhë asnjëri nuk kishte të drejtë të bënte investim as publik dhe as privat. Mbas viteve 90 shteti i pari bëri investim publik që bëri rrugët që i mban vetë, bëri dhe privati kështu që ne kemi pyetur për këtë punë vjet parvjet në çdo mbledhje që kemi bërë me AKMC-në me emergjencat dhe na thonë lumi Shkumbin i tillë është lënë për të shfryer ngarkesën e tepërt sepse po të bëj argjinatura nga krahu i Rrogozhinës na dilte jashtë loje agjinatura e krahut poshtë, kështu që këtu nuk ka masë parandalues. Njoftimin dhe për të ardhur në ndihmë ditën që ndodhi fatkeqësia ne i kemi ardhur në ndihmë edhe biznesit brenda ditës edhe një makinë e ngelur tek ura atje edhe të tjerëve që kanë pasur rrezik jete apo prone. Kthimi në identitet është faza e tretë megjithatë mbas ankesave që morëm nga bizneset dhe fermerët u ngrit komisioni me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe kemi vajtur në Spille mbi 15 lokale që pretendonin që është futur uji në bizneset e tyre. Pjesa më e madhe e tyre kanë liçenca provizore tre katër mujore që ishin të mbyllura. E dyta dëmi i tyre kishte ardhur nga bllokimi i një kanali të parë që këtu do rakordim se pse atë e ka bordi edhe atje ndihmuam me fadromë afër kanalit që u largua uji, megjithatë bëmë konstatimin e atyre bizneseve por ligji e ndanë dy pjesë kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe kur nuk shpallet, në rastin e dytë kur nuk shpallet

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

gjendja se në këtë rast emergjencat ose bashkia ka të drejtë vetëm banesat. Rrëshkitjet, shembjet, banesat elektroshpiakët të marri në konsideratë dhe t'i ndajë nga fondi i bashkisë për këtë rast ne kemi vetëm një rrëshkitje dheu tek shtëpia e Llon Toskut me të mbaruar studimi, urbanistika shërbimet do të ndërhyjnë të marrin masë parandaluese të bëjnë një murë mbrojtjes së mos na shembet banesa tij ka dalë 3 m afër. Për të tjerat ne bëmë konstatimin e biznesit po unë grupi i punës me inxhinierin aty është një kakofoni që nuk merr dot masë parandaluese nga bashkia. Aty duhet një, ne do dalim dhe në përfundim, aty duhet një studim i mirëfilltë sepse ata janë të gjithë pa kanalizime të ujërave të zeza dhe të bardha, të gjithë kanali i parë që duhet të mbledhi ujërat për t'i çuar tek hidrovori ata e kanë të bllokuar me tuba për të hyrë në objektet e tyre. Kështu që një ndër shkaqet që e kanë bllokuar janë dhe vetë ata kanalizme ujërave të zeza jo, të bardha jo, kanali bllokuar, kanali i parë i bllokuar ne kërkuam dhe nga bordi, bordi ju e dini që është në Durrës, Durrësi u mbyt vetë. Një nga faktorët që ne kemi parë në tokat që kemi dalë, një pjesë e jona një pjesë e tyre shumë mbeturina që hidhen nëpër kanale dhe shumë koka kanalesh ...se në momentin që uji futet nga lumi ai futet nga rritja e vëllimit del lart, ne duhet të ndihmojmë për tërheqjen e shpejtë, gjatë tërheqjes ai lë shumë mbeturina mbrapa, që janë bllokuar kokat e tombinat kokat e kanaleve me mbeturina plastika, ferra deri tek dyshekë çfarë nuk gjen. Kjo duhet të jetë pak më në qendër të vëmendjes që të ndërhyhet më shpejt për të për t'i ardhur në ndihmë për t'i pastruar. Një nga problemet kryesore është pika katër zhdëmtimi, gjithë turren dhe bëjnë kërkesa, por ne kemi një shpi të djegur dhe nuk po e zhdëmtojmë dot, sepse primari kryesor është çertifikata e pronësisë dhe akti i marrjes së tokës së 1991. Vjen kryefamiljari bën një ankesë thotë kam 17 dynym tokë, kur i sheh çertifikatën familjare është burrë e grua po ti dy norma ke nga dolën 17 nuk e lejon ligji... ju e patë në Tiranë u prishën shumë banesa dhe nuk morën lekë. Primari kryesor duhet të vërtetojë çertifikatën e pronësisë, ne kemi qenë kështu tek çdo... dhe pjesa më e madhe e atyre 90% thjesht nisen nga akti i marrjes në dorëzim po nga 91 deri më sot toka është e vlerësuar një pjesë është kthyer për biznes, një pjesë është shitur, një pjesë e kanë marrë fëmijëve e tjerë, e të tjerë nuk mund të aplikoj dot kryemiljari për tokën e fëmijës, vajzës, djalit, nuses, të tjerit, vetëm pjesën e tij. Kështu që puna me e madhe jonë duhet të jetë vetëm që kemi ankesa nga lagjet, numër një lagja jonë dhe lagjja sipër në kodër etj, ata janë rrugë që duan urbanizim nuk kemi ne çfarë i bëjmë ujit nuk mbajmë dot masë parandaluese që uji që vjen nga kodra lart mos kapë gjithë lagjet këtej poshtë, ajo vjen vetëm kur bëhet urbanizimi i rrugës, kanalizimet, mbrojtjet, pritat që vihen për zvogëlimin e rrymës së ujit edhe aty nuk kemi çfarë mase parandaluese të marrim. Ka një pjesë tjetër lagjet tek stadiumi që ankohen edhe kur bie shi edhe kjo është keq se është tokë me ligjin 7051 e kthyer në banesa mbyllur me avllia njëri-tjetrit se ku do shkojë uji nuk di se si edhe aty se si mund të ndërhysh. Edhe aty është pronë private edhe kërkohet urbanizim. Çdo vit Qerem Ballabani për shembull ka ankesën që uji i rri po ato avullitë prej betoni e bëjnë që uji të rri në vend dhe mos të ketë dalje as tek fqinja as tek komshiu as nuk di se çfarë mund të bëhet aty, këta duan studime të mirëfillta

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

lagje numër një nga kinemaja tek burgu e gjitha gati në raste shiu përmbytet, dalja e ujërave nga gropat septike kthehet në gangrenë edhe aty nuk mund të thuash të ndërhyjë emergjenca edhe aty do urbanizim.

Erind Tosku . Të bëj një parashtesë të kësaj gjësë, edhe analizës tënde i jap një farë të drejte se normalisht uji, zjarri janë ca gjëra nuk kemi kur janë fatkeqësi edhe janë në nivele shumë të mëdhaja nuk kemi çfarë i bëjmë, por besoj se po marr një shembull domethënë hidrovori i Vilës ka punuar?

Adriatik Leka . Po.

Erind Tosku . Ok, kur ikën për në Gërmej është ajo pjesa e urës që ishte bërë me bllokim nuk pashë një shirit që rruga është bllokuar

Adriatik Leka . Atëherë ajo ura është ekzistuese , ne i çuam zjarrfikësen i vendosëm një makinë atje.

Erind Tosku . E di. Një shirit një bllokim një diçka duhet të ketë, e dyta duhet të ketë edhe një deklaratë në media më të shpejtë për njerëzit që dinë se si veprojnë sepse jo të gjithë janë nëpër televizore nëpër media ka shkëputje energjie ka avari jashtë mase domethënë janë disa gjëra që dhe mund të kanalizojmë në disa gjëra, se Shkumbinit nuk kemi çfarë i bëjmë.

Adriatik Leka . Ligji e parashikon që në të tilla raste ne lidhemi me administratorët, administratorët lidhen me kryepleqtë, e kemi pjesën e informaconit.

Erind Tosku . Në pjesën malore rrjedhën nga shirat që bën ne e dimë normal që do ajo që thua ti kanalizimi të gjithë tjerat, por një devijim të rrjedhës e bëjmë një gjë të vogël minimaliste.

Adriatik Leka . Por nuk mban ku ta bësh, ajo vjen nga lart del tek stacioni i trenit.

Erind Tosku . Po do e gjesh edhe tek lagjet tek stadiumi ose lagjet tjera kërkoni një dëgjesë publike kërkoni që shiko kjo do jetë...

Adriatik Leka . Është pronë private.

Erind Tosku . Po një sekondë se nuk do asnjëri t'i mbytet shtëpia, kur e ka bërë gabimin vetë ose tjetri asnjëri s'do. E kam këtu llogjikën, një dëgjesë publike në qoftë se ato lagje përmbyten

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

për çdo vit një dëgjesë publike dhe ai nuk do një dëgjesë publike në qoftë se ato lagjet përmbyten për çdo vit, një dëgjesë publike që të kuptohet dhe të gjendet një zgjidhje me disa fonde private me ca fonde të bashkisë që të zgjidhet, se thua ti ke shtëpinë këtu e ke bërë ok po mbytet ai.

Edison Memolla . I gjithë qyteti i Rrogozhinës është me projekt të studiur dhe të miratuar.

Erind Tosku . Këtu e kisha.

Edison Memolla . Është projekti e kemi në sistem, projekti që po zbatohet është më si e tha Adriatiku është lagja numër një që ujërat e zeza i vijnë të gjithë edhe ujërat e bardha është në tenderim edhe është kjo e para që do meren masa.

Adriatik Leka . Edhe ligji parashikon kur ka ndodhur njëherë fatkeqësia thotë ai duhet ndërhyrë që të mos ndodhi më, aty ndodh çdo vit se nuk ndërhym dot.

Edison Memolla . Ka nevojë për investimet e duhura në vendet e duhura.

Adriatik Leka . Biznesi atëherë lumi filloi të dali nga data 31 deri me datën 10 duhet të merreshin masa të largoheshe vetë ti. Pika e dytë se pikës së parë s'ke çfarë i bën, ti nuk largohesh pastaj thua hajde se më hyri uji brenda. Ne prapë çuam zjarrfikësen e pastruam ujin po nuk zhdëmtojmë dot ne...

Erind Tosku . Po mos e zhdëmto, ti shko.

Mukades Gixhari . Zoti Enver Memolla.

Enver Memolla . Faleminderit kryetare, këto që tha Adriatiku nuk i hiqen as një pikë e as një presje nga e para tek e fundit. Po më pëlqeu që tha dhe gjënë e duhur. Shkumbini doli s'kemi çfarë i bëjmë se tokën e vet e ka atje, gjëja që nuk dëgjova ishte prita e Kalushit rrezikon?

Adriatik Leka . Jo, i vetmi problem që na ka mbetur pa zgjidhje është dhe ky këtu prapë kryetari, ja çova prapë atje, lumi Shkumbina rrezikon që të çajë rrugën tek Altini kur doli muajin e kaluar mora përfaqësues të prefekturës erdhën. Ne e kemi zgjidhjen studimi i 2021 ajo do çarë tek shtrati i vjetër kanë thënë ato. Sepse po çau xhaden do na dalë tek kanali i Grethit.

Edison Memolla . Dje ishim në një takim me ministrin e bujqësisë dhe kjo gjë do marrë zgjidhje.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Adriatik Leka . Atëherë kjo një dhe nuk futet fare në Spille pa studim të mirëfilltë nga e para, atje nuk ke çfarë mase merr.

Edison Memolla . Studimi i ujërave të zeza është bërë, do filloi.

Adriatik Leka . Po do hapur kanali para, është kanali ujërave të larta lart dhe kanali i parë çon ujin tek hidrovori është bllokuar i gjithë. Bizneset kanë vënë tuba të vogla poshtë kanë bërë hyrje tek lokali i vet. Tani u ankuan ata, ata ta bëjnë ankesën tek bordi, ne i takuam ata. Ore pse e mbyllet kokën, gjatë beharit ato çfarë bëjnë i mbyllin kanalet, i nivelojnë vetë për të krijuar sa më shumë parkingje makinash për të marrë lekë. Tashi ikin, ka mbyllur dyqanët dhe vijnë beharin tjetër, harrojnë pasojat e dimrit. Ky është kanali i ujërave të para është i bordit, kanali që del në det i bordit edhe hidrovorin bordi e ka se kemi ne.

Elton Xhani . Gjithë probleme që kemi pasur kanë qenë të gjithë kanalet e para. Nuk është se kemi...

Adriatik Leka . Kur ne i kërkojmë ndihmë bordit, bordi është në Durrës deri në fyt vetë. Po edhe kanale e treta që i kanë vetë fermerët nuk pashë një kanal të pastruar. Shkoi tek Qamili atje ai ka tre dynym tokë të treja i ka zaptuar me dega me lopë e me të gjitha, kanali para të vetin e ka bllokuar ai e sjell këtej pendencën duhet ta çajë para ...

Enver Memolla . Për të vazhduar aty ku e nisa, kryetare ne e dimë tani që dora e njeriut është problemi kryesor lumit si dalim dot para. Por dhe rrjedhshmëria e lumit ka ndryshuar sepse janë ngritur dhe diga lart. Hera e dytë ishte dalje shumë e shpejtë për pesë orë doli nga ku ishte dhe shkoj për pesë orë ishte 10 me 15 se e kam ndjekur nga afër por gjëja që më ka bërë përshtypje se faktikisht atje ku jam dhe unë, e kam shtëpinë e shoh Rrogozhinën në pëllëmbë të dorës, lumi u tërhoq për 12 orë, në parcela ndenji mbi 72 orë qoftë të mbjella e të pa mbjella , problemi kryesor është kanalet e dyta dhe e treta janë mosfunksionale. Sidomos për sa i përket pjesës nga sipër bypass-it, pothuajse tokat kanë dalë gjithë jashtë përdorimit, nga poshtë bajpasit ku kanali i parë i dytë deri në afër të rrugës që është tek kanteri janë të zeruara me blloqe. Unë e kam thënë dhe para dy vitesh lumi do dalë, uji do fryhet, por tërheqja duhet të jetë shumë e shpejtë. Unë isha zbrita vetë para dy ditësh tek Bishti i Zhurit është ai problemi që ka bypass-i është ai mbikalimi . Tani nuk duhet të qahemi çdo kohë që e ka fajin betoni e ka fajin rruga. Duhet bërë një projekt për të gjetur zgjidhje, ura e re edhe ura matanë është ngritur dhe kanali poshtë është mbi nivelin e pastrimit nuk ka forcë të tërheqi dhe pika nis nga zero nga grykëderdhja e këtij kanali. Nëse ai kanal funksionon nëse kanali mbas hekurudhës do ripastrohet dhe nëse do i gjendet zgjidhje kanalit të brukut që është bllokuar nga autostrada e bishtit të zhurit, ta jap unë

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

zgjidhjen sot që nuk rri më shumë uji se 24 orë aty. Nuk duhet tani t'i biem rreth e rrotull kemi dhe një sekondë kanë faj dhe vetë bujqit, po të shikosh dhe bizneset kanë faj se kanë bllokuar dhe rrugët kanë bllokuar dhe kanalet dhe hajde se u mbyta unë. Ai përroi Hakve aty është bërë një kalim në kalon njeriu aty kalonte Zisi e di shumë mirë Tiku.

Indrit Dedej . Është bllokuar?

Enver Memolla . Është bllokuar nga të gjithë gjërat, dihet që është dora e njeriut por tani ...

Adriatik Leka . Quhet përrua deri në 20 m e gjerë.

Enver Memolla . Do e frenojmë këtë dorë, apo do e lejmë pastaj themi s'kemi çfarë të bëjmë, prandaj po them duhet një projektstudim. Edhe rrugët lartë e kanë një zgjidhje elementare për momentin dhe nga fotot e bashkisë e kam thënë dy tre herë, tubat duan 1000 ose 500 poshtë nën dhè nëse ujërat futen brenda aty nuk prishet më ajo rrugë. Janë dy përrenj që ajo të dyja lagjet i komandojnë shumë mirë ato, dhe përroi që kalon në qendër të qytetit dhe përroi që del poshtë tek Haktë. Përroi i Shimve është mbyllur nga krahu matanë, bën dhe problemin tjetër që tapos kanalin e Zogut dhe nuk kullojnë tokat, ky është problemi madh që kemi ne, futja e tombinave në kanalet e larta që nuk lejohet në botë, tjetër tek kanali i ri, shyqyr Zotit ka ujë se po të kishte pasur ujë do kishte dal poshtë do kidjte ikur uji... Ideja është që duhet të bëhet tani tamam një plan afatgjatë ose afatmesëm për këtë pjesë.

Edison Memolla . Ne kemi plan me mjetin që e blemë po vazhdojmë punën por është e pamundur që mundim me një mjet se ti sa kalon bie një shi dhe do rikaluar përsëri.

Enver Memolla . Tani afatet e kam thënë njëherë herën e fundit kanalet mbarojnë shtator, ai ka shumë punë ka dhe shumë volum sepse duhet të hiqet dheu se ka shkuar kanali rrafsh me rrugën nuk duket rruga më edhe po të shkosh sot në çarje të hapësh kanalet kullues futi uji brenda.

Edison Memolla . Çarja ka dy problematika që ti i ceke nga kjo anë është e rregullueshme se zgjidhet e kemi pastruar, kurse pjesa e Bishtit të Zhurit që është tek rotondo dhe mbi nivelin e saj është ajo problemi që do 72 orë që do dhe kthimi i ujit i tharjes së tokës.

Enver Memolla . Ai është problem që duhet zgjidhur.

Elton Xhani . Problemi i bishit të zhurit nuk është se ka qenë në kanalet e dyta a të treta, problemi i bishtit të zhurit ka qenë vetëm tek tërheqja ujit tek kanali i parë, po nuk po

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

kundërshtoj atë që the ti. Çuam dy skrepa kanë punuar mbi dy orë, dy skrepa vetëm kanë hequr vetëm bidona edhe mbeturina të tjera që ka hedhur dora e njeriut, i jemi drejtuar dhe bordit për këtë pjesë edhe bizneset duhet ta kenë parasysh sepse kanë rrethuar kanë bërë gardhe e gjëra.

Adriatik Leka . Na u ankuan i hedhim mbeturinat në kanal se nuk ka kosh plehrash.

Enver Memolla . Tani o kryetar ka një problem mbase mund të jetë dhe cënim dhe për pjesën e lagjes poshtë tek Çamtë dhe siç e kam vënë re është një 25% bllokuar kanali i madh Peiqn-Kavaj nga kallamat dhe duhet patjetër një skrep i vogël që ta marri ta heqi po të duash të çoj unë ta shikosh ku është. Para dy ditësh e vura re dhe është rrezik sepse është tek shtëpia...

Elton Xhani . Tani firma që po punon aty nuk ka ikur akoma.

Enver Memolla . Prandaj po them është një punë që të bëhet taman, janë kallama që kanë mbirë brenda në kanal.

Elton Xhani . Ai kanali nuk ka nuk ka as gjashtë muaj që është bërë pjesës së njerëzve s'kemi çfarë i bëjmë, kallamave s'kemi çfarë i bëjmë, dorës së njerëzve s'kemi çfarë i bëjmë që i hedhin mbeturinat aty.

Indrit Dedej . Kanë rënë dy shtylla elektrike, janë dy familje...

Enver Memolla . O kryetar ka një shembje të kodrës së Memollve tek rruga nuk di nëse e kë vënë re, tek Ylli.

Silvana Aliu . Tek lagjja tek stadiumi se ajo familje që përmende e ka kështu për herë, dy herë, tre herë, tani nuk mund të ... bashkia të bëjë kanalizime se të gjithë familjet...

Adriatik Leka . Ne marrim informacion dhe kërkojmë nga bashkia të ndërhyjë dhe ne vetë si zyrë këtë bëjmë. Marrim informacion dhe i kërkojmë bashkisë të ndërhyjë se si ndërhyhet ne nuk jemi inxhiniera. Po ja kam kërkuar vjet, ja kam kërkuar prapë sivjet. Se çfarë ndërhyrje do bëhet nuk di t'i jap dot zgjidhje.

Enver Memolla . Kanali i poshtëm është funksional?

Edison Memolla . Funksional është i pastruar vjet.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Silvana Aliu . Thoni që është banesë private, duhet ta detyrojmë dhe tjetrin që ta kuptojmë diçka që ky personi ka nevojë.

Adriatik Leka . Unë e ngrita me emër nuk e ngritem në përgjithësi me emër. Çdo vit ka ankesë se si do bëhet nuk e di urbanistika. Të vetmen emergjencë që unë kam nga këto që nxorra që ka bashkia ka vendosjen e murit tek Ed Tosku.

Enver Memolla . Kam dhe një pyetje për Valin se harrova, tek lagja e çamëve, ato ujërat e zeza në sipërfaqe ju bëjnë përshtypje?

Valmira Troka . Më bëjnë shumë përshtypje.

Enver Memolla . Ke dy muaj.

Edison Memolla . Mos fol hiç s'ke çfarë flet kështu që rri shko zgjidhe, kaq.

Enver Memolla . Ka dy muaj kryetar.

Valmira Troka . Jo kam çuar dhe botin unë aty që mos prishja rrugën po nuk bëhet dot.

Edison Memolla . Gjej zgjidhje tjetër, zgjidh ashtu si të thashë unë sot.

Enver Memolla . Nuk i bën zgjidhje boti, ajo është bllokuar nga gjethet e pemëve. Çdo pusetë është 22 m larg maksimumi 24 dhe duhet të funksionojë zhbllokimi hapjes së pusetave fillimisht. Të gjitha pusetat i ke të bllokuara nga pemët, po nuk hape pusetë nuk hapet kanali të shtysh presion me ujë.

Edison Memolla . Nuk është pusetë është vetëm tranversimi i rrugës.

Valmira Troka . O Ver nuk është pjesa e pusetave se pusetat janë hapur por duhet të hapet komplet tuba se janë bllokuar tubat brenda.

Alime Hoxha . Aty dilte uji nga puseta që ishte në trotuar, duhet prishur rruga.

Adriatik Leka . Kemi dhe një urë ta ngre si problem në Zhabjak rrezikohen tre shtëpia. Ura atje është në nivel.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Mukades Gixhari . Atëherë kalojmë në pikën 10, shqyrtim i kërkesës së anëtares së këshillit bashkiak zonjës Silvana Aliu, shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 24/12/2025 zonja Silvana do shqyrtojë vetëm kërkesën që mban datën 21.11.2025.

Edison Memolla . Kush është kjo për materialet shkollore?

Mukades Gixhari . Ja t'i bëjmë telefon Gesit që të kthehet.

Edison Memolla . Atëherë materialet shkollore jua sjellim me listë, do listën e shpërndarjes. Lista e materialet shkollore të pajisura për vitin 2025, si i keni ndarë nëpër shkolla, gjithë urdhrat që i keni bërë nga zyra e magazinës...

Mukades Gixhari . Dhe institucionet që kanë përfituar. Tani kemi tek të ndryshmet shqyrtimi i shkresës së Ministrisë së Financave mbi mosrespektimin e kërkesave të ligjit. Kjo u diskutua, u prek nga zoti Indrit dhe nga... dhe tjetra është raporti i punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2025 për njohje e keni gjithë materialin përpara. Gjithashtu kemi ftuar, kemi thirrur dhe kryeinspektorin e policisë bashkiake sipas kërkesës së një grupi këshilltarësh për të shqyrtuar disa problematika lidhur me sektorin që ju mbuloni. Përshëndetje! atëherë zonja Silvana Aliu.

Edison Memolla . Atëherë plan masash vjetor çfarë keni realizuar e çfarë jo nga plani i masave.

Lorenc Boriçi . Nuk kam bërë një raport , policiaa bashkiake i ka marrë gjithë masat domethënë për ruajtjen e qetësisë dhe rendit në bashkëpunim dhe me Policinë e Shtetit ka qenë prezent në të gjithë aktivitetet që janë bërë brenda bashkisë Rrogozhinë brenda në qytet dhe nëpër plazhet e Spillesë. Janë liruar të gjitha hapësirat publike ato që kemi parë që janë të bashkisë Rrogozhinë. Kemi marrë të gjitha masat.

Silvana Aliu . Atëherë aq sa shoh brenda në qytet parkimi diçka nga fillimi nga stadium deri tek ajo pjesa e shkollës njëherë është bërë deri tani sepse parkohen zihet rruga dhe nuk...

Lorenc Boriçi . Ato janë parkime të shkurtra nuk është se parkojnë edhe qëndrojnë gjatë...

Edison Memolla . Parkimi rrugës kryesore. Atëherë ky është gabim që të venë gjoba duke ditur që e shohim që edhe vizimi ka nevojë të bëhet një vizim më i qartë dhe më i saktë se është parashikuar që këtë vit të bëhet vizimi i duhur dhe vend caktim i duhur sikur të jetë provizor dhe kur jetë për të gjithë kështu që planin e kemi bërë zyra e urbanistikës dhe do tua sjellim. Gjithsesi mbledhjen e radhës planin e masave në relacion para se të fillojë mbledhja, sa gjoba keni vendosur ku i keni vendosur...

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Alime Hoxha . Unë kam një pyetje, policia bashkiake është përgjegjëse për mbarëvajtjen e qytetit për trafikun e përgjithshëm, tani kjo ka kaluar po thjeshtë me e pasur. Në periudhën e festave policin bashkiake unë nuk e pashë gjëkundi ku në çdo rrugë ishte e bllokuar edhe nga shitja e fishekzjarreve që jo në trotuar por kishin dalë në rrugë pothuajse se po dilnin në xhade. Unë policinë bashkak nuk e pashë. Ajo periudhë ka krijuar një kakofoni me...

Edison Memolla . Mos i ngatërro gjërat se është e policisë së shtetit ajo.

Alime Hoxha . Edhe e bashkiakes edhe të shtetit të dyja.

Edison Memolla . Në momentin që dikush shet fishekzjarre jashtë vendit të duhur është e policisë së shtetit duhet të shikoni kompetencat mos i ngatërroni.

Alime Hoxha . Tani bllokimi i rrugës është dhe i policisë bashkiake, dhe për hapësirat publike tani mirë u mor një masë në fillim por duket sikur akoma prapë vazhdojnë ato.

Silvana Aliu . Masa kryesore që duhet të merret kyetar është që çdo dyqan unë e kam vënë re çdo dyqan shohin njëri-tjetrin dhe unë do ta bëj rrugën aty se është lulishte ka qenë shumë e bukur lulishtja nga rruga e Peqinit. Tani çdo dyqan ka bërë rrugën e vet, të merren masat...

Indrit Dedej . Të prishen, meri mbarë që mos i ngeli qejfi, jo atij ja prish e atij ja le, s'ke çfarë i do.

Lorenc Boriçi . Ne i pastruam njëherë të gjitha.

Edison Memolla . Nëse ju keni pika të caktuara bëni mirë të na i thoni dhe të marrim masa.

Lorenc Boriçi . Jemi marrë njëherë me të gjitha këto edhe i kemi pastruar të gjithë objektet.

Silvana Aliu . Me këto që je marrë mbledhjen e radhës na i sill.

Edison Memolla . Të gjithë objektet çfarë janë verifikuar.

Silvana Aliu . Tani ai ka dyqanin aty e merr pjesën gjithë para.

Lorenc Boriçi . Nuk ke që të marrin.

Silvana Aliu . Bëj një xhiro deri atje.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Edison Memolla . Kanë filluar prap ka të drejtë kështu që shikoje.

Silvana Aliu . Nëse paguajnë për atë pjesë ok, dhe janë fonde që hyjnë në bashki.

Edison Memolla . Jo nuk kemi dhënë trotuare me qera.

Mukades Gixhari . Ju faleminderit. Keni ndonjë gjë tjetër?

Indrit Dedej . Tek plani i punës së Këshillit ndonjë xhiro të vogël kështu...

Edison Memolla . Ta fikim njëherë pastaj e diskutojmë.

Mukades Gixhari . Atëherë meqë nuk kemi diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 12 : 30^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 01 orë 17 min ; 19 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 31 (tridhjetë e një).

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Nr.437 Prot. Rrogozhinë,më 30/01/2026

PROJEKT- VENDIM

Nr. ___datë __.___2026

"PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR "PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA"

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8,pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24 pika 2 , në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"i ndryshuar me ligjin nt.48/2023 " Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018" ,Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Rrogozhinë nr.52 datë 24.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Rrogozhinë ,Vendimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë me Nr.30 ,datë 19.08.2025 "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit "Përmirësim I kushteve të banesave ekzistuese ", Vendimin e Komisionit të Strehimit nr.3 datë 16.01.2026,shkresës së ardhur nga Ministria Ekonomisë dhe Inovacionit me nr 423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026-2027, bazuar në relacionin e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Kujdesit Social, Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë,

VENDOSI:

CamScanner

1. Të miratojë listën e familjeve që do të përfitojnë nga programi për "*Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara*" sipas tabelës 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Tiranë .

Konc.
Ledian Hasani

KRYETAR

Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me Urdhër
N/kryetar
Andi Proshka

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

CamScanner

Tabela nr. 1

Lista e familjeve për t'u trajtuar nga programi për "Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara"

Nr	Emër Atësi Mbiemër (kryefamiljari)	Nr. total i anëtarëve në familje, sipas çertifikatës familjare të 3 muajve të fundit	Kategoria së cilës i përket, sipas nenit 16 të ligjit nr. 22/2018	Niveli i të ardhurave mesatare mujore të familjes	Lloji i dokumentit të pronësisë	Numri i pasurisë dhe zona kadastrale, sipas dokumentit të pronësisë	Sipërfaqe e objektit ekzistues (m2)	Vlera e financimit
1	Latif Kadri Dedej	3 anëtar	Jo status i veçantë	Familjarë me te ardhura shumë të ulëta.	Çertifikatë pronësie	Nr i pasurisë 4/106-nd Zona kadastrale Nr 3234	130.8 m2	1,300,000 lekë
2	Sulejman Qazim Hasalla	4 anëtar	I moshuar/2 Familjarë me aftësi të kufizuar	Familjarë me te ardhura shumë të ulëta.	Çertifikatë pronësie	Nr i pasurisë 4/337+1-1 Zona kadastrale Nr 3234	35 m2	2,000,000 lekë
3	Fisnik Lutfi Haka	2 Anetar	Jo status i vecante	Familje me te ardhura shume te uleta	Certifikate pronesie	Numer i pasurise 96/1 Zona kadastrale Nr 2538	152 m2	1,000,000 leke

CamScanner

4	Arta Hekuran Sula	2 Anetar	Jo status i veçantë	Familjarë me te ardhura shumë të ulëta.	Çertifikatë pronësie	Numer i pasurise 84/24 Zona kadastrale Nr 3450	114.4 m2	1.000.000leke
							Shuma Totale	5.300.000 lekë

Nr. 497/1 Prot **RELACION PËR PROJEKT-VENDIMIN** Dt. 30.01.2026

"PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR

"PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA"

Të nderuar Këshilltarë!

Po ju a risjellim ktë projekt vendim për ndyshimet e bëra bazuar në shkresën e ardhur nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me nr.423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026-2027 ku në kostot e financimit për çdo familje ndryshojnë vlerat e granteve.Bashkia Rrogozhinë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8,pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24 pika 2 , në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"i ndryshuar me ligjin nt.48/2023 " Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018" ,Vendimin e Këshillit të Ministrave

CamScanner

Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Vendimin e Komisionit të Strehimit nr.3 datë 16.01.2026 , paraqet për votim projekt vendimin për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për "përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara.

Programi i përmirësimit të kushteve të banimit është pjesë e programeve të strehimit social i cili shërbejnë për familjet dhe të individëve që banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të amortizuar , në kuptim ligjit për strehimin social dhe që nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për përmirësimin e kushteve të jetesës.

Bashkia Rrogozhinë edhe për këtë vit ju përgjigj pozitivisht kërkesës së Ministrisë së Financave për të aplikuar dhe të perfitoj fondet në kuadër të thirjes "Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2026".

Duke u nisur nga kërkesat e qytetarëve, banesat e të cilëve janë të amortizuara dhe jashtë kushteve teknike, Bashkia Rrogozhinë për këtë vit po kryen të gjitha procedurat dhe përgatitjen e dokumentacionit për të aplikuar për këtë projekt. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social në Bashkinë Rrogozhinë mori në shqyrtim kërkesën e 4 (katër) aplikantëve.

Fillimisht është bërë shqyrtimi i dokumentacionit për secilin qytetar/familje aplikant dhe duke zbatuar parashikimet ligjore të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese , u hartua lista dhe u krye renditja e aplikantëve.

Komisioni i Strehimit me Vendim Nr 3 datë 16.01.2026 vendosi të kualifikojë 4 aplikantë nga 7 që kishin aplikuar, 3 aplikantë u skualifikuan për shkak se banesat i përmbushnin kushtet për të qenë të banueshme. Aplikantët që nuk përfitojnë janë, Shefqet Hamid Dushku ,Sali Ahmet Aliu , dhe Edmond Shefit Beu .Familjet jo përfituese janë njoftuar me anë të shërbimit Postar për vendimin e marrë nga ana jonë .Komisioni u bazua në proçes-verbalet e grupit të punës me nr 380 datë 13.10.2025 ngritur nga Kryetari I Bashkisë Rrogozhinë dhe proçes-verbalet e grupit të punës të ngritur me Urdhër nr.7,prot datë 12.01.2026 "Për ngritjen e Komisionit për riferifikimin e gjendjes faktike të objekteve në lidhje me ankesat e qytetarëve " ,ku për çdo familje janë bërë konstatimet përkatëse.
Të gjithë aplikantët e kualifikuar kanë banesat me probleme të theksuar me lagështinë në atë nivel sa rrezikohet dhe ana shëndetësore e familjarëve që jetojnë në këto banesa. Duke qenë se aplikantët i përkasin kategorisë me të ardhura shumë të ulëta dhe një prej tyre kanë në përbërjen dy familjarë me aftësi të kufizuar mundësia financiare e tyre është shumë e ulët që ata të arrijnë të bëjnë rregullimet që iu nevojiten banesave.

CamScanner

Theksojmë se aprovimin përfundimtar të familjeve aplikuese e vendos Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Sherbimit Mbrojtjes dhe Kujdesit Social pasi kryen shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit nga bashkia për këtë program.

Nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese do të trajtohen, 4 familje të cilat i përmbushin kriteret për tu kualifikuar, me një shumë totale prej 5,300,000 lekë sipas tabelës nr.1 pjesë përbërëse të projekt vendimit.

Për sa shpjeguam më lartë, propozojme votimin e projekt vendimit " *Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për "përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara".*

Drejtori I Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Ledian Hasani

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Nr._____Prot. Rrogozhinë.më ___/____/2026

Projekt-Vendim

Nr. ___datë __.___2026

"PËR MIRATIMIN NE PARIM TË DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR "PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PER VITIN 2026"

Mbështetur në shkresën e ardhur nga Ministria e Ekonomisë ,Kulturës dhe inovacionit me nr me nr 423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2026-2027.
Bashkia Rrogozhinë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8,pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24 pika 2 , në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"i ndryshuar me ligjin nr.48/2023 " Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018" ,Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese". I propozojmë Këshillit Bashkiak

CamScanner

Të Vendosi

1.Miratimin në parim të deklatatës për bashkëfinancim të familjeve që do përfitojnë nga programi" Përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese për komunitet e varfëra dhe të pafavorizuara " për aplikim sipas shpalljes së thirrjeve për bashkëfinancim . për rikonstruksion të banesave në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.

2. Marrjen përsipër në momentin e fitimit të projektit të vlerës që i takon bashkëfinancimit të Bashkisë, 2.120.000(dy million e njëqind e njëzet mijë) lekë, nga zëri buxhetor 00 / 1110 / 05 / 2312118, pra 40% e vlerës totale 5 300 000 (pesë million e treqind mijë) lekë të preventivit të projektit të pasqyruar në projekt vendimin e 4 (katër) familjeve përfituese për vitin 2026 .ku 3 180 000 (tre milion e njëqind e tetë dhjetë mijë) lekë ose 60 % të vlerës e mbulon Ministria Ekonomisë,Kulturës dhe Inovacionit.

Konc.
Ledian Hasani

KRYETAR

Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me Urdhër

N/kryetar

Andi Proshka

CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Nr. 498 Prot. Rrogozhinë,më 30 / 01 /2026

DEKLARATË

Nr. ___datë __.___2026

"PËR BASKËFINANCIM TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR "PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PER VITIN 2026"

Mbështetur në shkresën e ardhur nga Ministria e Ekonomisë ,Kulturës dhe inovacionit me nr me nr 423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2026-2027.

1.Miratimin në parim të deklatatës për bashkëfinancim të familjeve që do përfitojnë nga programi" Përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese për komunitet e varfëra dhe të pafavorizuara " për aplikim sipas shpalljes së thirrjeve për bashkëfinancim , për rikonstruksion të banesave në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.

2. Marrjen përsipër në momentin e fitimit të projektit të vlerës që i takon bashkëfinancimit të Bashkisë, 2,120,000(dy million e njëqind e njëzet mijë) lekë, nga zëri buxhetor 00 / 1110 / 05 / 2312118, pra 40% e vlerës totale 5 300 000 (pesë million e treqind mijë) lekë të

preventivit të projektit të pasqyruar në projekt vendimin e 4 (katër) familjeve përfituese për vitin 2026 ,ku 3 180 000 (tre milion e njëqind e tetë dhjetë mijë) lekë ose 60 % të vlerës e mbulon Ministria Ekonomisë,Kulturës dhe Inovacionit.

Konc.

Ledian Hasani

KRYETAR

Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me Urdhër

Kryetar

Andi Proshka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VIÇ - NJËSIA VETËQEVERISËSE

Nr. 494/1 prot

RELACION PËR PROJEKT -VENDIMIN

Dt 30.01.2026

"PËR MIRATIMIN NE PARIM TE DEKLARATËS PER BASHKEFINANCIM TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR "PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PER VITIN 2026"

Të nderuar Këshilltarë!

Po ju a risjellim për miratin projekt-vendimin për deklaratën e bashkëfinacimit për ndyshimet e bëra bazuar në shkresën e ardhur nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me nr.423 prot datë 28.01.2026 për projektet e investimeve që do të financohen nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026-2027 ku në kostot e financimit për çdo familje ndryshojnë vlerat e granteve dhe % që i takon Bashkisë Rrogozhinë.Bashkia Rrogozhinë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8,pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24 pika 2 , në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"i ndryshuar me ligjin nr.48/2023 " Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018" ,Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese".

CamScanner

Bashkia Rrogozhinë edhe për këtë vit ju përgjigj pozitivisht kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për të aplikuar dhe të perfitoj fondet në kuadër të thirjes "Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2026".

Duke u nisur nga kërkesat e qytetarëve, banesat e të cilëve janë të amortizuara dhe jashtë kushteve teknike, Bashkia Rrogozhinë për këtë vit po kryen të gjitha procedurat dhe përgatitjen e dokumentacionit për të aplikuar për këtë projekt. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social në Bashkinë Rrogozhinë mori në shqyrtim kërkesën e 4 (katër) aplikantëve.

Theksojmë se aprovimin përfundimtar të fondit e vendos Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Sherbimit Mbrojtjes dhe Kujdesit Social pasi kryen shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit nga bashkia për këtë program.

Nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese do të trajtohen, 4 familje të cilat i përmbushin kriteret për tu kualifikuar, me një shumë totale prej 5,300,000 lekë ku Bashkia Rrogozhinë merr përsipër në momentin e fitimit të projektit të vlerës që i takon bashkëfinancimit të Bashkisë, 2,120,000(dy million e njëqind e njëzet mijë) lekë, nga zëri buxhetor 00 / 1110 / 05 / 2312118. pra 40% e vlerës totale 5 300 000 (pesë million e treqind mijë) lekë të preventivit të projektit të pasqyruar në projekt vendimin e 4 (katër) familjeve përfituese për vitin 2026 ,ku 3 180 000 (tre milion e njëqind e tetë dhjetë mijë) lekë ose 60 % të vlerës e mbulon Ministria Ekonomisë,Kulturës dhe Inovacionit.

Për sa shpjeguam më lartë, propozojme votimin e *"PROJEKT-VENDIMIT* PËR MIRATIMIN NE PARIM TE DEKLARATËS PER BASHKEFINANCIM TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR "PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA PER VITIN 2026"

Drejtori I Mbrojtjes dhe Kujdesit Social

Ledian Hasani

CamScanner